



# KOMUNA E MALISHEVËS



# BULETINI

Nr. 138-Maj 2015 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Pamje gjatë asfaltimit të rrugëve



## Përmbajtja:

|   |    |
|---|----|
| Nga mbledhja e Këshilli të Drejtorëve .....   | 3  |
| Dezinsketohen oborret e dy familjeve, kundër rriqrave.....  | 4  |
| Komiteti për Diasporë mbajti mbledhjen e radhës.....  | 5  |
| Gjimnazistët nga Orhangazi, vizituan Malishevën .....   | 5  |
| Ministri Bajrami: Qendra e Kompetencës në Malishevë, model i shkollimit profesional .....           | 6  |
| Malisheva dhe Hani Elezit, shkëmbejnë përvojat për këshillat e fshatrave .....                      | 7  |
| KK i Malishevës, mori vendim për dhënien në shfrytëzim të pishinave në Banjë .....                  | 8  |
| Po vazhdon largimi i deponive ilegale të mbeturinave.....   | 9  |
| Balinca, nderon të rënë të luftës .....   | 10 |
| Situata me EHKK nën kontroll, javën e ardhshme pritet të filloj dezinfektimi .....                  | 11 |
| KK i Malishevës, kërkon nga Kryeparlamentari dhe Kryeministri, kthimin e shërbimeve në Prizren..... | 12 |
| Begaj, vizitoi pemishten e “EBE” sh.p.k. e cila ka të mbjella 35 hektar me fidane të mollës .....   | 13 |
| KEDS në bashkëpunim me komunë do ta përmirësojnë rrjetin energjetik në Malishevë.....               | 14 |
| Pastrohet ambienti afër liqenit “Mirusha” .....   | 15 |
| Nesër fillon dezinfektimi kundër rriqrave .....   | 16 |
| Shtrohet rruga në fshatin Shkarashnik .....   | 17 |
| Filloi fushata e dezinfektimit në Malishevë.....  | 18 |
| Zëvendësministri i Diasporës, viziton komunën e Malishevës .....                                    | 19 |
| U mbajt takimi i parë i KO për shënimin e 16 Qershorit.....   | 20 |
| IKSHP inkurajon komunën në luftimin e etheve hemorragjike .....                                     | 21 |
| U mbajt tryezë konsultative lidhur me praktikat e komunës për vizita në terren dhe komunikim .....  | 22 |
| Begaj: Projektet kapitale hartohen në bazë të kërkesave të vendbanimeve .....                       | 23 |
| Begaj: Projektet kapitale hartohen në bazë të kërkesave të vendbanimeve .....                       | 23 |
| Komuna dhe "Miq të Amerikës", organizojnë evenimentin "Faleminderit Norvegji" .....                 | 24 |
| Komiteti për Politikë dhe Financa, mbajti mbledhjen e pestë.....                                    | 25 |
| Mbahet testi i arritshmërisë në Komunën e Malishevës .....  | 25 |
| U zhvillua aksioni “Ta pastrojmë Malishevën” .....  | 26 |
| Komuna dhe ministria, biseduan për mbrojtjen dhe kujdesin e pyjeve .....                            | 27 |
| Asfaltohet rruga kryesore në qendër të Malishevës .....   | 27 |



|  |    |
|--|----|
| Asfaltohen edhe tri rrugë në fshatrat e Malishevës .....                           | 28 |
| Këshilli i Drejtorëve: Shumë projekte në realizimin e sipër .....                  | 29 |
| Këshilli organizativ, përcaktoi agjendën për shënimin e 16 Qershorit .....         | 31 |
| Largohen mbi 600 tonelata mbeturina .....  | 32 |
| Berisha bëhet me rrugë të asfaltuara .....   | 33 |
| Po vazhdon fushata e dezinfektimit kundër rriqrave .....                           | 34 |
| Pas njoftimit nga qytetari E.Mazreku, largohet edhe një deponi e mbeturinave ..... | 35 |

## Nga mbledhja e Këshilli të Drejtorëve

### **Malishevë, 4 maj**

Këshilli i Drejtorëve, i udhëhequr nga kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur sot takimin e rregullt, e me këtë rast, drejtorët e drejtorive kanë raportuar për punët dhe aktivitetet e drejtorive që ata drejtojnë, për javën që lamë pas dhe për planifikimi për javën në vijim.

Drejtori për Urbanizëm z.Skënder Rrahmanaj bëri të ditur se aktualisht janë duke u realizuar disa projekte, kryesisht në infrastrukturë, si në infrastrukturë shkollore, rrugore, kanalizime, dhe të tjera. Ka filluar edhe rregullimi i rrugëve kryesore në qytet, për eliminimin e prishjeve të rrugëve.

Nga ana tjetër drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim z.Ahmet Morina, duke folur për çështjen e etheve hemorragjike tha se “ numri i të thumbuar veç ka filluar të rritet, dhe me kërkesën e dy familjeve gjatë ditës së sotme do të intervenohet për dezinfektimin e oborreve të tyre”

Ndërsa sa i përket çështjes së arsimit drejtori z.Blerim Thaçi tha që në drejtorin për Arsim dhe Edukim “janë zhvilluar disa aktivitete në të cilat kemi qenë të angazhuar, siç ka qenë Kosova vizion kontest, ku në komunën tonë kanë përfituar katër shkolla, ka përfunduar edhe testi PISA, ndërsa si drejtori jemi duke bërë përgatitjet e testit të maturës”.

Drejtori për Bujqësi, z.Hajrullah Mazreku, po ashtu bëri të ditur që gjatë kësaj jave pritet të ketë ndihma konkrete në sektorin e pemëtarisë .



## Dezinsketohen oborret e dy familjeve, kundër rriqrave

### Malishevë, 04 maj



Me kërkesën e familjarëve, sot është duke u bërë dezinsketimi kundër rriqrave, në oborret e dy familjeve, njëra në Dragobil dhe tjetra në Bellanicë, pasi sipas kryefamiljarëve, në oborret e tyre ka rriqra dhe kanë nevojë që të bëhet dezinsketimi i oborreve, në mënyrë që të jenë më të sigurt në oborret e tyre.

Sipas drejtorit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Ahmet Morina, “në të dy rastet, qytetarët, përkatësisht kryefamiljarët e dy familjeve, njëra në Dragobil dhe tjetra në Bellanicë, kanë kërkuar që të bëhet dezinsketimi kundër rriqrave dhe për këtë, drejtorja ka organizuar dezinsketim të parakohshëm, pasi një gjë e tillë na është kërkuar nga qytetarët”.

Përndryshe, drejtori Morina, në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, ka njoftuar për këtë aktivitet dhe ka bërë të ditur se numri i personave të thumbuar nga rriqrat është duke u rritur, ndërsa në rastet e tilla, kur qytetarët janë të shqetësuar nga prania e rriqrave dhe kërkojnë ndihmën e drejtorisë, do të intervenohet në të gjitha rastet, derisa të filloj spërkatja selektive e zonave endemike.

Megjithatë, sipas drejtorit Morina, edhe pse pritet që gjatë këtij muaji të filloj fushata e dezinsketimit selektiv, ende nuk ka lëvizje konkrete nga ana e Këshillit Ndërministror, që përcjellë situatën endemike, lidhur me virusin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK).

## Komiteti për Diasporë mbajti mbledhjen e radhës

### Malishevë, 4 maj



Komiteti për Diasporë, i udhëhequr nga kryesuesi, z.Besnik Hoti, ka mbajtur sot mbledhjen e pestë të radhës, e me këtë rast, kanë diskutuar për çështje të ndryshme që lidhen me punën e këtij komiteti , ndërsa nga kjo mbledhje, kanë dal me disa kërkesa si komitet.

Komiteti për Diasporë gjatë këtij takimi kanë dalë me disa rekomandime dhe kërkesa të cilat janë në të mirë të bashkatdhetarëve tanë, ku kanë kërkuar nga zyrtari për diasporë të sjell raportin e punës i cili identifikon numrin e emigrantëve që jetojnë jashtë vendi, pastaj hapja e një zyre për bashkatdhetar, në mënyrë që bashkatdhetarët të din ku të adresohen dhe gjithsesi që këtu do të jetë bashkëpunimi i bashkatdhetarëve edhe me komitet, dhe konsiderojnë se më këtë do të kanë një komunikim më të mirë dhe më të suksesshëm.

## Gjimnazistët nga Orhangazi, vizituan Malishevën

### Malishevë, 4 maj



Një grup prej dhjetë gjimnazistëve turq, të Gjimnazit nga Orhangazi, sot kanë vizituar Komunën e Malishevës dhe Gjimnazin “Hamdi Berisha”, ku janë njohur me Kryetarin e Komunës, z.Ragip Begaj dhe me udhëheqjen e gjimnazit në Malishevë, si dhe me nxënësit e këtij gjimnazi. Komuna e Malishevës, është e binjakëzuar me Komunën e Orhangazit, nga rrethi e Bursës në Turqi.

Fillimisht, kryetari Begaj, i ka pritur në zyrën e tij, drejtorin gjimnazit turk të Orhangazit, z.Ayhan Sariboğa, të cilin e ka falënderuar për vizitën në Komunën e Malishevës, duke e rritur kështu bashkëpunimin mes Malishevës dhe Orhangazit, si dhe i ka përcjellë përshëndetjet e tij drejtuar popullit dhe udhëheqjes së Orhangazit.

Më pas, delegacioni nga Turqia, ka vizituar edhe Gjimnazin “Hamdi Berisha” në Malishevë, ku janë takuar me drejtorin e kësaj shkolle, z.Izet Hoti, profesorët dhe nxënësit e gjimnazit, të cilët kanë biseduar mes vete për vazhdimi e bashkëpunimit mes dy gjimnazeve dhe shkëmbimin e përvojave të mira.

## Ministri Bajrami: Qendra e Kompetencës në Malishevë, model i shkollimit profesional

### Malishevë, 5 maj



Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), z.Arsim Bajrami, sot ka qëndruar në Malishevë, përkatësisht në Qendrën e Kompetencës, të cilën e ka quajtur si një shkollë model i mësimit profesional, ndërsa ka premtuar mbështetje për këtë qendër të arsimit profesional. Ndërsa kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, ka kërkuar nga ministri Bajrami, mbështetje më të madhe, për rritjen e cilësisë në mësimin profesional.

Fillimisht, ministri Bajrami, i shoqëruar nga kryetari Begaj, drejtori i arsimit në Malishevë, z.Blerim Thaçi, deputetët e Kuvendit të Kosovës, z.Salih Morina, Enver Hoti dhe Shukrije Bytyçi, bashkë me drejtorin e Qendrës së Kompetencës në Malishevë, z.Nazmi Zogaj, kanë vizituar hapësirat e brendshme të shkollës, dhe me këtë rast ministri Bajrami, u njoftua me kushtet e mësimit, për rreth 900 nxënësit e kësaj shkolle profesionale.

Ndërsa në takimin e përbashkët, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, duke e falënderuar për vizitën, ministrin e MASHT-it, e vlerësoi si ministrin më të mirë, që ka Qeveria e Republikës së Kosovës”. “Është nder për Qeverinë e Kosovës, ta ketë një ministër siç është ministri Bajrami”, tha kryetari Begaj. Ndërsa duke folur për Qendrën e Kompetencës, kryetari Begaj, tha se “kjo shkollë është prej më të mirave në vend, por me gjithë të arriturat, dëshiroj që të rritet kualiteti i mësimdhënies dhe për këtë kërkoj mbështetje më të madhe nga ana e ministrit”. “Unë besoj në reformat për rritjen e cilësisë në arsim dhe jam kundër centralizimit”, tha kryetari Begaj, duke aluduar në Agjencinë për Mësimin Profesional, që sipas kryetarit Begaj deri më tani nuk është treguar i suksesshëm mënyra e centralizimit, përmes kompetencave, të shkollave profesionale.

Ndërsa ministri Bajrami, duke marrë fjalën, tha se “MASHT-i, është duke punuar që deri në 2016-tën, shkollat profesionale të jenë autonome dhe të vet menaxhohen”. Fillimisht ministri

Bajrami, tha se “kjo shkollë është model për shkollat e ngjashme, për realizimin e mësimit cilësor”. Duke folur për mësimin parauniversitar, ministri Bajrami, tha se “shkollat profesionale do të funksionojnë sipas modeleve evropiane dhe ju në këtë shkollë, e praktikoni këtë formë të mësimit dhe përgatitjes profesionale dhe kjo shkollë është pikë referente për të gjitha shkollat, për zhvillimin e mësimit teorik dhe praktik dhe unë ju premtoj se do të punojmë për gjetjen e fondeve shtesë, në mënyrë që të sigurojmë mbështetje për këtë shkollë me mjete konkretizuese, në mënyrë që të arrihet qëllimi për të cilën edhe është hapur kjo shkollë profesionale”.

Duke folur për zhvillimet e përgjithshme në sistemin e arsimit parauniversitar, ministri Bajrami, tha se “janë duke punuar në depolitizimin e shkollave”, ndërsa Qendrën e Kompetencës në Malishevë, e quajti një “aset”, për krijimin e kuadrove për tregun e punës.

## Malisheva dhe Hani Elezit, shkëmbejnë përvojat për këshillat e fshatrave

### Hani Elezit/Malishevë, 6 maj



Organizuar nga OSBE, misioni në Kosovë, sot në Komunën e Hani Elezit, është mbajtur një takim i përbashkët, mes Malishevës dhe Hani Elezit, në nivel të kryetarëve dhe drejtorive përkatëse, për shkëmbimin e përvojave të mira të funksionalizimit të këshillave-kryesive të fshatrave dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve, përkatësisht udhëheqësive të fshatrave, në proceset e ndryshmet të vendimmarrjes dhe hartimit të prioriteteve komunale.

Fillimisht, duke hapur takimin, zyrtari i OSBE-së, z.Yusuke Hara, tha se “Funksionalizimi i këshillave-kryesive dhe kryetarëve të fshatrave është me rëndësi, ndërsa shkëmbimi i përvojave, mes dy komunave, mundëson funksionalizimin më të mirë të këtyre fshatrave dhe pjesëmarrjen e tyre, në hartimin e prioriteteve të komunës”.

Ndërsa kryetari i Komunës së Hani Elezit, z.Refki Suma, tha se “Ne si komuna, kemi nevojë për shkëmbimin e përvojave dhe jo vetëm në këtë fushë, por edhe në fusha tjera”. Ndërsa kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, tha se “Është mirë që rregulloret për zgjedhjet në fshatra, organizimi dhe funksionalizimi i tyre, është mirë që të shkëmbehen mes komunave”. Begaj e Suma, thanë se është mirë që këto përvoja, të merren nga komunat brenda Kosovës, dhe të mos merren përvoja nga vendet e huaja, pasi ato përvoja nuk përkojnë me ligjet në Kosovë.



Për mekanizmat ekzistues dhe praktikat e organizimit të këtyre këshillave, përkatësisht kryetarëve dhe kryesive të fshatrave, i prezantuan, z.Muharrem Morina, këshilltar ligjor në Komunën e Malishevës dhe z.Bashkim Sopa, zyrtar për informim në Komunën e Hani Elezit.

## **KK i Malishevës, mori vendim për dhënien në shfrytëzim të pishinave në Banjë**

### **Malishevë, 7 maj**



Kuvendi i Komunës së Malishevës, drejtuar nga kryesuesi i saj, z.Aziz Thaçi, ka mbajtur mbledhjen e pestë të rregullt, ku ka marrë disa vendime me rëndësi, e në mesin e tyre edhe dhënien në shfrytëzim për dy vite të Pishinave në Banjë, si dhe ka miratuar rregulloren për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha komunale. Në këtë mbledhje, KK ka marrë edhe disa vendime tjera.

Fillimisht, anëtarët e KK të Malishevës, kanë miratuar kërkesën e Kryetarit të Komunës, për kompensimin e pronës së eksproprijuar, e që ka të bëjë me pronën, ku është e ndërtuar një pjesë e objektit të QKMF-së, e po ashtu kanë miratuar edhe kërkesat e tre personave, për ndërrim destinimin e tokës bujqësore, në tokë ndërtimore.

Më pas anëtarët e KK-së, kanë shqyrtuar raportin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, lidhur me të hyrat dhe shpenzimet e Pishinave në Banjë, dhe pas shumë diskutimeve, anëtarët e KK-së, kanë marrë vendim për dhënien në shfrytëzim me afat prej dy vitesh, të pishinave në Banjë të Malishevës.

KK, po ashtu pas shqyrtimit ka miratuar Rregulloren për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha komunale, për vitin 2015, e ku me këtë rregullore, parashihen edhe ulje të taksave për lejet e ndërtimit, si dhe ulje të taksave në disa shërbime të gjeodezisë dhe kadastrit.

Ndërsa një vendim me shumë rëndësi, është edhe vendimi për çështjen e stacionit të autobusëve në Malishevë, ku anëtarët e KK-së, pas shqyrtimit dhe debatit të zhvilluar, kanë marrë vendim për marrjen e procedurave për zyrtarizimin (formalizimin) e kalimit si pronë publike komunale .



## Po vazhdon largimi i deponive ilegale të mbeturinave

### **Malishevë, 8 maj**

Edhe ky vit, për kryetarin e Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, pastrimi i ambientit, do të vazhdoj të mbetet një prej prioriteteve, dhe për këtë gjë, kryetari Begaj, në të gjitha takimet publike, dhe në takimet direkte me banorët, ka kërkuar që ambienti të pastrohet dhe të largohen deponitë ilegale të mbeturinave. Për këtë qëllim, kryetari Begaj dhe drejtoria e shërbimeve publike, në bashkëpunim me njësinë e “Eko regjionit” në Malishevë, nga fillimi i muajit prill, është duke bërë largimin e këtyre deponive ilegale të mbeturinave.

Sipas drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Komunale, z.Milazim Morina, në bashkëpunim me inspektoratin komunal dhe me “Eko regjionin”, kanë evidentuar deponitë ilegale të mbeturinave, dhe kanë hartuar një plan për largimin e këtyre deponive. “Plani është duke u realizuar sipas parashikimit dhe deri më tani janë larguar apo varrosur mbeturinat në shumicën e deponive ilegale”, ka thënë drejtori Morina.

“Grumbullimi i deponive të mbeturinave, pa planifikim, bartë rreziqe të ndryshme, jo vetëm në aspektin ekologjik, por edhe shëndetësor, pasi si pasojë e këtyre mbeturinave, kanosemi edhe nga ndonjë epidemi, dhe më e keqja, jo vetëm që e degradojmë ambientin, por po ju krijojmë kushte ideale për grumbullimin e qenve endacak, pastaj shumimin e brejtësve, dhe si rezultat edhe bartjen e rriqrave dhe virusit të etheve hemorragjike krime kongo. Prandaj, ju bëj thirrje, që së bashku ti largojmë këto mbeturina dhe të mos i hedhim përsëri mbeturinat, por të kujdesemi për shëndetin tonë”, ishin fjalët e kryetarit Begaj, në takimet me banorët nëpër vendbanimet e Komunës së Malishevës.

Largimin e këtyre deponive, është duke e kryer kompania për menaxhimin e mbeturinave, “Eko regjioni”, njësia në Malishevë. Sipas menaxherit të njësisë së “Eko regjionit” në Malishevë, z.Nuhi Shala, “deri më tani janë pastruar 33 fshatra, ku janë larguar nga një deri në pesë deponi ilegale, në një vendbanim”.

Përveç, këtij aksioni dhe fushatave të vazhdueshme për mbrojtje të ambientit, nuk kanë munguar as aktivitetet vullnetare, siç është 1 prilli, pastaj disa organizime nga nxënësit, dhe në këtë muaj, me 22 maj, pritet të organizohet edhe një aksion i madh për largimin e mbeturinave, në kuadër të projektit “Ta pastrojmë Kosovën”.

Me këtë rast, ju bëhet thirrje qytetarëve, që të mos i hedhin mbeturinat në fusha dhe male, apo afër vendbanimeve, në mënyrë që të krijohet një ambient të sigurt për jetë dhe të mos bëhemi armik i vetvetes.

Shumë fshatra të Komunës së Malishevës, janë të futur në sistemin e grumbullimit të mbeturinave. Sipas menaxherit të njësisë së “Eko regjionit”, z.Shala, në sistemin e grumbullimit të mbeturinave, janë 33 vendbanime, apo 72% e vendbanimeve dhe me këtë rast ju bëhet thirrje, vendbanimeve, që të futen në sistemin e grumbullimit të mbeturinave, në mënyrë që të kemi një

## Balinca, nderon të rënët e luftës

### Malishevë, 8 maj



Në fshatin Balincë, sot është bërë zbulimi i lapidarit të ngritur, në nderim të të gjithë të rënëve të luftës së fundit. Zbulimi i lapidarit, është bërë, pikërisht në shënimin e fillimit të luftimeve mes forcave të UÇK-së dhe forcave serbe, me 8 maj të vitit 1998. Kjo datë është e shënuar në historinë e Komunës së Malishevës, edhe fillimi i luftës së drejtpërdrejt mes. Po ashtu në Balincë, janë shënuar edhe viktimat e para të luftës në Malishevë.

Në ceremoninë e zbulimit të lapidarit, ka marrë pjesë edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, me bashkëpunëtor. Në fjalën e rastit, kryetari Begaj, tha se “ndihet krenar, që gjendet në vendit e arsimit, pasi ky fshat është prej fshatrave që ka nxjerrë shumë kuadro të arsimit dhe ka dhënë një kontribut të madh në arsimimin e kësaj treve. Sot kam emocione të veçanta, pasi jemi në ditën dhe vendin, ku për herë të parë kemi filluar luftimet kundër forcave serbe. E di dhimbjen që keni ju familjarët e të rënëve dhe e ndajë këtë dhimbje me ju. Balinca, është vendi, ku për herë të parë u derdh gjak në territorin e Malishevës, në kohën e luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ne sot, duhet të punojmë, duhet ta ndërtojmë vendin, të arsimohemi, që vendi ynë të zhvillohet dhe ky ka qenë edhe mesazhi dëshmorëve të kombit, nga Balinca dhe nga të gjitha trevat, që dhanë jetën për lirinë që sot e gëzojmë”, ka thënë mes tjerash, Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj.

17 vite më parë, në Balincë, kanë filluar luftimet mes UÇK-së dhe forcave pushtuese serbe. Balinca, në luftën e fundit, i ka dhënë vendit tre dëshmorë dhe 22 martir të kombit.

Zbulimin e lapidarit e ka bërë, Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, bashkë me familjarët e të rënëve nga Balinca.



## **Situata me EHKK nën kontroll, javën e ardhshme pritet të filloj dezinfektimi**

### **Malishevë, 12 maj**

Në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve, në kuadër të raportimeve të drejtorive, para kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, u bë e ditur, se situata epidemiologjike, me ethet hemorragjike krime kongo (EHKK), është në kontroll, edhe pse me ngritjen e temperaturave ka filluar të shtohen thumbimet nga rriqrat, ndërsa javën e ardhshme, pritet të filloj edhe dezinfektimi selektiv, kundër rriqrave.

Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, z.Hajdin Berisha, bëri të ditur, “se numri i rasteve të thumbuar nga rriqrat, po shtohet për shkak të rritjes së temperaturave, por në krahasim me vitin e kaluar, ky numër është dukshëm më i vogël, ndërsa asnjë rast nuk është i regjistruar me EHKK dhe kjo është një gjë e mirë”. Berisha, bëri të ditur, se numri i të thumbuarve ka arritur në 205 raste të regjistruara në QKMF të Malishevë, ndërsa sipas kontakteve që ka me kompaninë e kontraktuar nga organet qendrore, fushata e dezinfektimit apo spërkatja selektive, e zonave endemike, pritet të filloj në javën e ardhshme.

Edhe drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, z.Hajrullah Mazreku, ka bërë të ditur, se procesi i repelimit të kafshëve, në fazën e dytë, po ecën mirë dhe krejt kjo bëhet në kuadër të zbatimit të strategjisë, në luftimin dhe parandalimin e EHKK.

Sa i përket aktiviteteve tjera, drejtorët e drejtorive komunale, duke raportuar në Këshillin e Drejtorëve, thanë, se edhe aksioni-projekti për largimin deponive ilegale të mbeturinave po ecën mbarë dhe deri të tani, janë pastruar rreth tetëdhjetë për qind e deponive ilegale, kurse me 22 maj, pritet të organizohet edhe aksioni i madh i pastrimit, në kuadër të fushatës “Ta pastrojmë Kosovën”.

Sa i përket fushës së investimeve, sipas drejtorive përkatëse, u bë e ditur, se projektet janë duke vazhduar me intensitet dhe sipas planifikimit, ku deri në shtator, pritet të përfundoj ndërtimi i dy shkollave, pastaj mirëmbajtja e rrugëve, është duke u bërë mirë dhe janë në fazën e përgatitjes për rregullimin e rrugëve ku janë dëmtuar në qytet dhe vendbanime tjera.



## **KK i Malishevës, kërkon nga Kryeparlamentari dhe Kryeministri, kthimin e shërbimeve në Prizren**

### **Malishevë, 12 maj**

Përmes një shkrese zyrtare, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, z.Aziz Thaçi, ju është drejtuar Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, z.Kadri Veseli dhe Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, z.Isa Mustafa, përmes së cilës, njoftohen dy organet më të larta të vendit, për mbështetjen e KK të Malishevës, lidhur e kërkesën kryetarëve të fshatrave, për ndalimin e kalimit të shërbimeve në Regjionin e Gjakovës dhe kthimin e tyre në regjionin e Prizrenit.

Në shkresën kryesuesit të KK të Malishevës, z.Aziz Thaçi, mes tjerash thuhet: Ne edhe një herë kërkojmë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës, që ti merrni në shqyrtim dhe në miratim, kërkesat e tona legjitime.

“Shikuar në prizmin historik, Komuna e Malishevës, ishte e lidhur me rajonin e Prizrenit, ne nuk kemi dhe nuk ndiejmë asgjë të keqe për rajonin e Gjakovës, por ne jemi të thirrur ti mbrojmë interesin e qytetarëve në aspektin ekonomik, emocional, gjë që është vlerë demokratike të cilën ne duhet ta mbrojmë”, thuhet mes tjerash në shkresat e dërguar Kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli dhe z.Isa Mustafa.

## Begaj, vizitoi pemishten e “EBE” sh.p.k. e cila ka të mbjella 35 hektar me fidane të mollës

### Malishevë, 13 maj



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori për bujqësi, z.Hajrullah Mazreku, në kuadër të vizitave tek fermerët e suksesshëm, sot kanë vizituar, njërën prej pemishteve më të mëdha, “EBE” sh.p.k. e cila aktualisht ka të mbjella rreth 35 hektar me fidan të mollës. Me këtë rast, kryetari Begaj, i ka uruar për punën e madhe që janë duke bërë në këtë pemishte dhe ju ka dëshiruar suksese në zhvillimin e kësaj dege me rëndësi të bujqësisë.

“Rajoni ynë njihet si një prej rajoneve, ku më së shumti ka mundësi të rriten pemët, si dardha, molla dhe të tjera, dhe ky investim i juaji, në rritjen dhe kultivimin e mollës, është shumë i qëlluar. Unë ju dëshiroj suksese në punën tuaj dhe uroj që të rritni kapacitetet edhe më shumë”, tha kryetari Begaj, gjatë vizitës në punëtorinë e shartimit të fidanit të mollës.

“Kjo pemishte, është shembull i mirë i punës dhe kultivimit të pemëve dhe do të dëshiroja, që edhe të tjerët të merren me këtë veprimtari, pasi rajoni ynë ka kushte ideale për rritjen e pemëve, si ato tradicionale, ashtu edhe pemëve tjera, ndërsa edhe fitimi nga pemët, është shumë i madh”, tha Begaj.

Pronarët dhe punëtorët e punëtorisë, ku bënë shartimin e fidaneve të mollës, e kanë falënderuar kryetarin Begaj dhe drejtorin Mazreku, për vizitën, ndërsa u shprehën të gatshëm për rritjen e kapaciteteve në kultivimin e mollës dhe pemë ve tjera. “Sikur të kishim mbështetje më të madhe nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, ne do ta dyfishonim mbjelljen e mollës, apo llojeve tjera, dhe rrjedhimisht edhe rritjen e numrit të punëtorëve”, thanë pronarët e “EBE” sh.p.k.

## KEDS në bashkëpunim me komunë do ta përmirësojnë rrjetin energjetik në Malishevë

### Malishevë, 14 maj



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori për ekonomi, buxhet dhe financa, z.Vesel Krasniqi, sot kanë pritur në një takim pune, drejtorin ekzekutiv të operimit të rrjetit në KEDS-it, z.Mehmet Koç, drejtorin e distribuimit në Gjakovë, z.Agnez Furra dhe koordinatorin e njësisë së KEDS-it në Malishevë, z.Dardan Krasniqi, ku kanë biseduar për përmirësimin dhe investimet në rrjetin energjetik në Malishevë dhe u pajtuan për bashkëpunim të ndërsjellë, në përmirësimin gjendjes aktuale, si dhe për

investime të reja në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, në territorin e Komunës së Malishevës.

Fillimisht, kryetari Begaj, e falënderoi drejtorin Koç, për gatishmërinë e tyre, për vizitën dhe për bashkëpunimin. “Kemi trashëguar një gjendje jo të mirë dhe me shumë probleme në sistemin e shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike. Në rrjetin e tensionit të lartë, është investuar mirë, por ka shumë probleme në rrjetin brenda vendbanimeve. Ne kemi nevojë për ndërtimin e një trafostacioni për ujëmbledhësin në Senik, kemi nevojë që në qytet të bëjnë një sistem nëntokësor të rrjetit energjetik, si dhe kemi nevojë për investime në disa vendbanime, për përmirësimin e furnizimit me energji elektrike, pasi në shumë fshatra, kemi një rrjet energjetik, që është vendosur para viteve të ’70-ta”, tha kryetari Begaj.

Ndërsa, drejtori ekzekutiv i KEDS, z.Mehmet Koç, tha se KEDS, “është i gatshëm të bashkëpunoj me komunën, në të gjitha projektet për përmirësimin e rrjetit energjetik. KEDS, do të investoj në të gjitha projektet për rregullimin e rrjetit dhe furnizimit me energji elektrike, dhe këtë vit, janë duke u bërë disa investime në këtë drejtim”.

Begaj dhe Koç, u pajtuan që bashkërisht të punojnë, në mënyrë që sa më shpejt të filloj edhe ndërtimi i rrjetit nëntokësor për shpërndarjen e energjisë elektrike, në qytetin e Malishevës, në mënyrë që të hiqen shtyllat e shumta nga rrugët dhe trotualet dhe vendet tjera që pengojnë lëvizjen e qytetarëve, ndërsa ky sistem, përveç pamjes më të mirë në qytet, eliminon edhe humbjet e energjisë elektrike.

## Pastrohet ambienti afër liqenit “Mirusha”

### Malishevë, 15 maj



E iniciuar nga shoqata e peshkatarëve sportiv “Sykuqi”, dhe përkrahur nga Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, shkolla fillore në Mirushë, organizata tjera joqeveritare, inspektorati komunal, drejtorja e shërbimeve publike, njësia e “Eko regjioni” në Malishevë, shërbimi i zjarrfikësve dhe shpëtimit, iniciativa “Ta pastrojmë Kosovën”, sot është bërë pastrimi i ambientit përreth liqenit “Mirusha” në Mirushë.

Qëllimi i këtij aksioni, ishte pastrimi dhe vetëdijesimi i qytetarëve, për ruajtjen e ambientit dhe krijimi i një ambienti të pastër në prag të fillimit të sezonit turistik dhe sezonit të peshkimit, pasi liqeni “Mirusha”, është njëri prej vendeve më të vizituar gjatë sezonit turistik dhe sezonit të peshkimit, ndërsa e tërë rrjedhja e lumit Mirusha, njihet edhe lumi me peshkun më të mirë.

Me rastin e fillimit të pastrimit, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, duke folur me nxënësit e shkollës së fshatit dhe me pjesëmarrësit tjerë, tha se pastrimi i ambientit është edhe një prej prioriteteve komunale, dhe për këtë qëllim, në vazhdimësi, janë duke u angazhuar për largimin e mbeturinave. “Ju bëj thirrje, të gjithë qytetarëve dhe të gjithë atyre që vizitojnë këtë liqe dhe vende tjera turistike, që maksimalisht ta ruajnë ambientin dhe të mos hedhin mbeturina, pasi ambienti i pastër, do të thotë edhe shëndet i mirë për të gjithë, prandaj ta ruajmë në rend të parë shëndetin tonë dhe të mos i pengojmë edhe të tjerët”, tha Begaj.

Përndryshe në aksionin e sotëm, kanë marrë pjesë rreth 120 persona, ndërsa numri më i madh, ishte nga shkolla e fshatit Mirushë, gjegjësisht nxënësit e klasave të nënta dhe të teta, të cilëve ju printe drejtori i shkollës.

Pastrimi i ambientit në liqenin Mirusha, është në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme të Komunës së Malishevës dhe organizatave tjera, për pastrimin e ambientit.

Edhe në javën tjetër, pritet të mbahet aksioni i madh në nivel vendi “Ta pastrojmë Kosovën”, dhe rrjedhimisht ky aksion do të organizohet edhe në Malishevë dhe me këtë rast ju bëhet thirrje për pjesëmarrje masive, në largimin e mbeturinave, por edhe në ruajtjen e ambientit, dhe të mos hidhen mbeturinat në vendet ku ndotet ambienti dhe vështirësohet e rrezikohet jeta e qytetarëve.



## Nesër fillon dezinfektimi kundër rriqrave

### **Malishevë, 18 maj**

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur sot mbledhjen e rregullt të së hënës, të Këshillit të Drejtorëve, me ç'rast u bë e ditur, se nesër, varësisht prej kushteve atmosferike, pritet të filloj edhe fushata e dezinfektimit kundër rriqrave. Në këtë fazë, do të bëhet spërkatje selektive, e zonave endemike, dhe kjo bëhet në kuadër të zbatimit të strategjisë për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK).

Sipas drejtorive përkatëse, të angazhuara në luftimin e EHKK-së, u bë e ditur se, se përgatitjet janë bërë dhe kompania e përcaktuar nga Ministria e Bujqësisë, pritet që të martën të startoj me spërkatjen selektive të zonave endemike, kundër rriqrave, si masë parandaluese për mbrojtje nga prekja e virusit të EHKK.

Po ashtu edhe drejtorja e bujqësisë, ka bërë të ditur se edhe faza e dytë e repelimit të kafshëve pro ecën mirë dhe nuk ka probleme. Repelimi kafshëve, bëhet në kuadër të luftimit dhe parandalimit të EHKK.

Nga raportimet e drejtorive, tjera, u bë e ditur se sot, do të filloj asfaltimi i një rruge në fshatin Shkarashnik, ndërsa janë sanuar dëmtimet e rrugës në fshatin Gurbardh. Po ashtu u bë e ditur se është duke u rregulluar edhe kanalizimi i ujërave atmosferik në qytetin Malishevës, ku shumica e defekteve janë evituar dhe ky sistem tashmë është funksional.

Në mbledhjen e sotme, u diskutua për përgatitjet për shënimin e 16 Qershorit- Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.

## Shtrohet rruga në fshatin Shkarashnik

### Malishevë, 19 maj



Në kuadër të angazhimeve të Komunës së Malishevës, për kompletimin e infrastrukturës rrugore në brendi të fshatrave, është shtruara edhe një rruga në fshatin Shkarashnik. Punimet gjatë shtrimit të kësaj rruge, i ka parë nga afër edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i cili i shoqëruar nga drejtori i urbanizimit, z.Skënder Rrahmanaj dhe ai për arsim, Blerim Thaçi, i kanë uruara banorët e këtij fshati për rregullimin e kësaj rruge.

“Kjo rrugë është edhe një investim i yni në rregullimin e infrastrukturës rrugore, me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetesës për të gjithë banorët e Komunës së Malishevës. Investimi në Shkarashnik, tregon se ne jemi të përkushtuar që të investojmë në çdo vendbanim, sidomos aty ku qytetarët asnjëherë nuk e kanë ndier prezencën e pushtetit, pasi në këtë fshat asnjëherë nuk është investuar”, tha mes tjerash kryetari Begaj, i cili i uroi banorët e Shkarashnikut për rrugën e re, e cila lidh një pjesë të madhe të fshatit.

Nga ana tjetër, banorët e Shkarashnikut, e kanë falënderuara Komunën e Malishevës dhe kryetarin Begaj, për këtë investim, i cili përveç që ju lehtëson lëvizjen, për herë të parë e ndiejnë që janë pjesë e komunës, sepse edhe këtu, sikur në vendbanime tjera, po investohet.

Përndryshe, kjo rrugë e gjatë 2.7 kilometra, është në brendi të fshatit dhe lidh pjesën më të madhe të fshatit me rrugën kryesore, që e lidh me qendrën komunale dhe fshatrat përreth.

## Filloi fushata e dezinfektimit në Malishevë

### Malishevë, 19 maj



Në kuadër të zbatimit të strategjisë nacionale për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), krahas masave tjera, sot ka filluar edhe fushata e dezinfektimit selektiv, të zonave endemike në territorin e Komunës së Malishevës. Fillimin e kësaj fushate, e ka përcjellë nga afër edhe kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, drejtori për mbrojtje dhe shpëtim, z.Ahmet Morina dhe përgjegjësit tjerë komunal.

Sipas drejtorit për mbrojtje dhe shpëtim, z.Ahmet Morina, dezinfektimi ka filluar në fshatin Drenovc, për shkak se këtë vit, janë regjistruar numër më i madh i rasteve të thumbimeve nga rriqrat, ndërsa në disa faza, do të inskenohet i tërë territori i Komunës së Malishevës.

Morina, tha se “spërkatjen është duke e kryer kompania “Truly Nolen”, ndërsa preparati që përdoret për spërkatje është “Masterline Bifinthin 7.9”. Në këtë fushatë të dezinfektimit janë të angazhuar rreth 50 punëtor, të pajisur me pompa dore dhe makineri lëvizëse, si traktor, kamioneta dhe të tjera”.

Po ashtu, në të njëjtën kohë, është duke vazhduar edhe repelimi i kafshëve, ndërsa Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, është duke kryer të gjitha shërbimet për rastet e thumbimeve nga rriqrat, të cilat paraqiten në QKMF të Malishevës.

Sipas drejtorit për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, numri i rasteve të thumbimeve deri më sot është 325 raste dhe fatmirësisht, nuk është regjistruar asnjë rast i infektimit me EHKK.

## Zëvendësministri i Diasporës, viziton komunën e Malishevës

### Malishevë, 19 maj



Kryetari i Komunës së Malishevës z.Ragip Begaj, sot ka pritur në një vizitë zëvendësministrin e Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës z.Sahit Krasniqi, ku kanë biseduar kryesisht për përgatitjet rreth pritjes së bashkatdhetarëve tanë nga diaspora dhe kushteve për plotësimin e kërkesave të bashkatdhetarëve që kryesisht kanë të bëjë me kompletimin e dokumentacioneve në gjendjen civile, si dhe mobilizimin e regjistrimit të tyre.

Kryetari Begaj, fillimisht e ka mirëpritur këtë takim dhe ka falënderuar zëvendësministrin Krasniqi, ku dhe para tij tha. “Unë e di se ajo kategori e njerëzve që jetojnë dhe veprojnë jashtë vendi, meritojnë shumë, ata kanë mbajtur arsimin, zhvillimin ekonomik dhe gjithçka tjetër, si para luftës, gjatë luftës dhe mbas saj, mërgimtarët janë ata që na kanë mbajtur, dhe kanë kontribuar për vendin, dhe unë jam i prekur me sjelljen ton ndaj diasporës ngase ata meritojnë shumë më shumë nga ne” tha Begaj në fjalën e tij.

Ndërsa zëvendësministri i Diasporës z.Sahit Krasniqi, tha se “Shpresoj që komunat të janë të mobilizuara për krijimin e kushteve sa më të volitshme për bashkatdhetarët për kohën sa qëndrojnë këtu në Kosovë, ngase ata meritojnë shumë dhe nuk ka çmim që i paguan ata”, ku më pas, Krasniqi ka biseduar edhe për një proces shumë të rëndësishëm, i cili është regjistrimi i diasporës ku dhe i ka ftuar bashkatdhetarët që t’i përgjigjen pozitivisht regjistrimit, sepse është një proces shumë i rëndësishëm i Kosovës për të ditur numrin e tyre



## U mbajt takimi i parë i KO për shënimin e 16 Qershorit

### **Malishevë, 19 maj**



Këshilli Organizativ (KO), për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, ka mbajtur sot takimin e parë. KO drejtohet nga kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ndërsa anëtar të këshillit janë përfaqësuesit e të gjitha subjekteve politike në Malishevë, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta dhe Policia e Kosovës.

Në këtë takim, u diskutua për disa propozime, për mënyrën e shënimin të 16 Qershorit, ku anëtarët e KO, dhanë mendimet e tyre rreth organizimit të kësaj date, ndërsa anëtarët e këshillit, thanë se do të angazhohen maksimalisht që organizimi të shkoj si është më së miri.

16 Qershori, është dita kur nga Komuna e Malishevës, janë larguar forcat e fundit të ushtrisë dhe policisë serbe, dhe në të njëjtën datë, me 16 Qershor 1998, ka rënë dëshmori i parë në Komunën e Malishevës, dhe me 16 qershor 1999, ka rënë dëshmori i fundit.

Në territorin e Komunës së Malishevës, kanë qenë të organizuara dy brigada të UÇK-së, 121 dhe 122.

## IKSHP inkurajon komunën në luftimin e etheve hemorragjike

### Malishevë, 20 maj



Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP), inkurajon Komunën e Malishevës, në luftimin e përbashkët të etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), në kohën kur bartësit e këtij virusi (rriqrat) janë më aktiv dhe rastet e thumbimeve të rriqrave mund të jenë në shkallë më të lartë. Për këtë qëllim, drejtori i IKSHP-së, z.Naser Ramadani, sot ka vizituar Malishevën dhe është takuar me nënkryetarin e komunës, z.Rexhep Mazreku, kryesuesin e KK-së, z.Aziz Thaçin dhe drejtorin për shëndetësi z.Hajdin Berisha, me të cilët kanë biseduar për situatën endemike në Malishevë.

“Ne sot, në kuadër të angazhimeve tona, për luftimin dhe parandalimin e EHKK, e kuadër të kësaj në vetëdijesimin e qytetarëve për kujdesin nga thumbimi i rriqrave, ne ja kemi dhuruar QKMF-së në Malishevë, dy monitor, për emetimin e spoteve, në ambientet e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë”, tha drejtori i IKSHP-së, z.Naser Ramadani.

Ndërsa nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Raxhep Mazreku, e ka falënderuar drejtorin Ramadani, për këtë donacion, si dhe për përkrahjen e vazhdueshme, në përcjelljen e situatës endemike në Malishevë dhe përpjekjeve të përbashkëta për luftimin e EHKK.

Edhe kryesuesi i KK të Malishevës, z.Aziz Thaçi, e ka falënderuar drejtorin Ramadani dhe IKSHP, për këtë donacion dhe praninë e tyre në Malishevë, duke e vlerësuar si një përkrahje edhe morale për Malishevën.

Paraprakisht, drejtori i IKSHP-së, z.Ramadani, ka qëndruar në QKMF të Malishevës, ku edhe e ka dorëzuar donacionin e IKSHP-së, si dhe ka parë nga afër edhe trajtimin e personave të thumbuar nga rriqrat, që ju bëhet nga stafi mjekësor në emergjencën e QKMF-së, si dhe është njoftuar nga ana e drejtorit të QKMF-së, z.Besim Zogaj, lidhur me aktivitetet e stafit mjekësor, me ligjëratat e mbajtura me qëllim të vetëdijesimit, si dhe me trajtimin që ju bëhet rasteve të thumbuara.

## U mbajt tryezë konsultative lidhur me praktikat e komunës për vizita në terren dhe komunikim

### Malishevë, 20 maj



Organizuar nga OSBE, misioni në Kosovë, sot është mbajtur një tryezë e rumbullakët konsultative, me temën “praktikat e komunës për vizitat në terren dhe komunikim”. Në këtë tryezë, morën pjesë, përfaqësuesit e komisionit komunal për hartimin e strategjisë komunale për transparencë, kryesuesi i KK të Malishevës, z.Aziz Thaçi, përfaqësues të OJQ-ve lokale, gazetarë lokal dhe përfaqësues të KDI-së.

Fillimisht, zyrtari i OSBE-së, z.Yusuke Hara, duke e hapur takimin, foli për qëllimin e këtij takimi, ku për qëllim tha se ka “rritjen e transparencës komunale, përmes pjesëmarrjes së publikut, ndërsa i tërë projekti i OSBE-së, dhe përmes këtij projekti të fuqizohet transparenca përmes komunikimit dhe rritja e pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje”.

N fjalën e tij, kryesuesi i KK të Malishevës, z.Aziz Thaçi, e vlerësoi lartë bashkëpunimin me OSBE, në hartimin e strategjisë komunale dhe rritjen e kapaciteteve për transparencë. “Transparenca e begaton demokracinë dhe e ofron qeverisjen lokale me qytetarin”, tha kryesuesi Thaçi.

Më pas, Zyra për Informim Publik, prezantoi para të pranishme, praktikat e mira të komunikimit, me masën dhe format që Komuna e Malishevës, i praktikon në raport me qytetarët, përmes takimeve të drejtpërdrejta me qytetarët, dy herë në vit, në çdo vendbanim, si dhe me formën e bashkëpunimit me mediet, përmes së cilave, synohet që informacioni për zhvillimet në komunë, të shkon te qytetari dhe përmes takimeve të drejtpërdrejta të hartohen edhe politikat e qeverisë komunale, përfshi edhe hartimi i buxhetit.

Ndërsa z.Muharrem Morina, nga zyra ligjore e kryetarit, prezantoi kornizat ligjore, që kanë të bëjmë me transparencën dhe sqaroi edhe rolin që publiku-qytetari mund të jap në hartimin e rregulloreve komunale, ku qytetarët mund të japin kontributin kryesor në hartimin e rregulloreve.

Më pas është zhvilluar edhe një debat, me të pranishmit, ku përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe medieve, i kanë dhënë disa rekomandime, lidhur me hartimin e strategjisë për transparencë dhe për komunikim.

## Begaj: Projektet kapitale hartohen në bazë të kërkesave të vendbanimeve

### KDI mbajti takim me kryetarët e fshatrave

## Begaj: Projektet kapitale hartohen në bazë të kërkesave të vendbanimeve

### Malishevë, 21 maj



Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), sot ka mbajtur një takim me kryetarët e fshatrave të Komunës së Malishevës, e ku i pranishëm ishte edhe kryetari i komunës, z.Ragip Begaj, kryesuesi i KK-së, z.Aziz Thaçi, anëtarë të Kuvendit të Komunës, ndërsa tema këtij takimi ishte “Problemet e qytetarëve dhe reflektimi i në planifikimet e hershme në projekt buxhetin e komunës”. Në këtë takim, kryetari Begaj, tha se planifikimi për investime kapitale, bëhet duke

u bazuar në kërkesat e vendbanimeve.

Fillimisht, zyrtari i KDI-së, z.Naim Cahani, shpjegoi arsyen e këtij takimi, ku sipas tij, përmes këtij takimi, “synohet identifikimi i problemeve të qytetarëve të Komunës së Malishevës, dhe prioritetizimi i tyre në planifikimin dhe hartimin e politikave publike nga institucionet lokale të Komunës së Malishevës”.

Ndërsa kryetari i Komunës së Malishevës, duke marr fjalën, tha se “ Jemi munduar të punojnë, duke u bazuar në kërkesat dhe nevojat e qytetarëve dhe vendbanimeve, ku përmes takimeve të drejtpërdrejta, i kemi evidentuar nevojat dhe më pas i kemi futur në planifikim buxhetor për investime, kapitale. Pra, për neve, prioritetet janë hartuar duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve. Kjo formë e takimeve dhe identifikimi i nevojave, e rrjedhimisht edhe hartimi i prioriteteve komunale për investime, është bërë model edhe për komunat tjera”.

Më pas kryetari Begaj, shpjegoi edhe çështjen e buxhetit për investime kapitale. “Këtë vit kemi më pak buxhet për rreth 800 mijë euro, për investime kapitale, kjo për shkak të rritjes së pagave, që qeveria e vendit, e ka bërë, por pavarësisht kësaj, jemi munduar që investimet, ti bëjmë tërësisht në bazë të prioriteteve të nxjerra nga takimet me qytetarët”.

Më pas është zhvilluar një debat mes kryetarëve të fshatrave dhe kryetarit të komunës, ku përfaqësuesit e fshatrave, i kanë paraqitur kërkesat e tyre, si dhe kanë bërë pyetje për kryetarin,



në raport me investimet kapitale, ndërsa në të gjitha pyetje, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, është përgjigjur.

## **Komuna dhe "Miqte e Amerikës", organizojnë evenimentin "Faleminderit Norvegji"**

**Malishevë, 21 maj**



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur në një takim pune, përfaqësuesin e shoqatës “Miqte e Amerikës”, z.Agim Rexhepi, me të cilin janë dakorduar për finalizimit të procedurave, për shpalljen e ish ambasadorit amerikan Christopher Hill “Qytetar nderi” i Malishevës, si dhe u nënshkrua marrëveshja për bashkëpunim në organizimin e ngjarjes me karakter kulturoro-politik “Faleminderit Norvegji”.

Qëllimi i organizimit të këtij eventi politiko-kulturor, qu propozua nga shoqata “Miqte e Amerikës”, është respekti dhe falënderimi për popullin norvegjez, për të gjithë atë që kanë bërë për popullin dhe institucionet e Kosovës para, gjatë dhe pas luftës në aspektin kulturor, sportiv, ekonomik e politik dhe për Malishevën në veçanti.

Kryetari i Komunës së Malishevës z.Ragip Begaj u dakordua që të organizojë një eveniment të tillë dhe u shpreh i gatshëm për bashkëpunim me shoqatën.

## **Komiteti për Politikë dhe Financa, mbajti mbledhjen e pestë**

### **Malishevë, 21 maj**

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), organ i Kuvendit të Komunës, i cili udhëhiqet nga kryesuesi i KK-së, z.Aziz Thaçi, sot ka mbajtur mbledhjen e pestë të radhës, ku ka dhënë disa rekomandime, për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës.

Bazuar në rendit e ditës, KPF, ka rekomanduar për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, raportin financiar për tre muajin e parë të vitit 2015, pastaj rekomandim tjetër ishte edhe raporti i punës për vitin 2014 dhe plani i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2015.

Ndërsa rekomandimi i tretë, i KPF-së, ishte edhe inicimi i procedurave për plotësim dhe ndryshimin e rregullores për transparencë.

## **Mbahet testi i arritshmërisë në Komunën e Malishevës**

### **Malishevë, 22 maj**



Nënkryetari i Komunës së Malishevës z.Rexhep Mazreku së bashku me drejtorin për Arsim dhe Edukim z.Blerim Thaçi, kanë vizituar nga afër procesin e mbarëvajtjes së testit të arritshmërisë, për nxënësit e klasëve të nënta, ku më këtë rast edhe ju dëshiruan nxënësve suksese , në mbarëvajtjen e këtij testi.

Në komunën e Malishevës testi u mbajt në tri shkolla në qendrën e Malishevës, në Gjimnazin” Hamdi Berisha” Shmu “Ibrahim Mazreku” dhe Qendrën e Kompetencës, ku këtij testi ju nënshtruan gjithsejtë

1542 nxënës, 86 paralele, ndërsa administrues ishin 132 veta . Komision mbikëqyrës ishin përfaqësues nga Ministria e Arsimit, DKA, dhe drejtorët e shkollave ku është mbajtur testi.

Ndërsa, rezultatet nga testimi i arritshmërisë për nxënësit e klasave të nënta do të shpallet me datën 28 maj 2015.

## U zhvillua aksioni “Ta pastrojmë Malishevën”

**Malishevë, 22 maj**



Aksioni i pastrimit të ambientit “Ta pastrojmë Kosovën” gjegjësisht largimi i mbeturinave nga deponitë ilegale, u organizua edhe në Malishevë i cili ka filluar që nga ora 10:00, aksion të cilit i ka prirë i pari i komunës së Malishevës z.Ragip Begaj me të gjithë administratën komunale, si dhe të gjitha institucionet tjera, edhe pse kushtet atmosferike, përkatësisht reshjet e shiut, kanë ndikuar në zhvillimin e plotë të aktivitetit, në këtë aksion pastrimi kanë marr pjesë edhe qytetar të shumtë.

Në këtë aksion pastrimi janë përfshirë të gjitha institucionet, nga Kuvendi Komunal, policia të cilët kanë bërë sigurimin e aksit rrugorë Prishtinë-Rahovec, Malishevë-Kijevë dhe Malishevë-Suharekë. Po ashtu pjesëmarrës tjerë ishin edhe të gjitha kompanitë publiko-private, si ajo e higjienës, e ujësjellësit “Hidroregjioni”, e cila ka marr pjesë me një ekskavator dhe me personel. Këtë aksion e kanë mbështetur edhe dy kopani private kompania “Jehona” e cila ka marrë pjesë me një ekskavator dhe “Vëllezërit Jahaj”, me një ekskavator dhe kamion.

Aksionit “Ta pastrojmë Kosovën” nuk i kanë munguar edhe organizatat e të rinjve dhe shoqatat e ndryshme të cilat veprojnë në komunën e Malishevës, si dhe qytetarët ku numri i pjesëmarrësve ishte rreth 400 qytetar.

Gjatë këtij aksioni janë grumbulluar rreth 24 tonë mbeturina, ndërsa materialin higjienik si thasë, dorëza, dhe të tjera, është kujdesur komuna e Malishevës.

## Komuna dhe ministria, biseduan për mbrojtjen dhe kujdesin e pyjeve

### Malishevë, 22 maj



Kryetari i Komunës së Malishevës z.Ragip Begaj dhe drejtori për bujqësi, z.Hajrullah Mazrekun, kanë pritur sot, zyrtarët e ministrisë së bujqësisë z.Besim Zogaj drejtor i drejtoriatit qendror të inspektoriatit për pylltari dhe gjueti, dhe z.Ali Buzhala, drejtor i drejtorisë regjionale në Prizren, ku kanë biseduar rreth ruajtjes dhe herrjes së pyjeve.

Gjatë këtij takimi drejtori i drejtorisë qendrore të inspektoriatit për pylltari dhe gjueti z. Besim Zogaj, e ka njoftuar kryetarin Begaj dhe drejtorin Mazreku për projektin e herrjes së pyjeve, ku dhe do të angazhohen për dy muaj disa punëtor të cilët do të pastrojnë pyllin (herrjen) në rajonin e bjeshkëve të Berishës.

Me marrëveshjen edhe të kryetarit Begaj, u dakorduan që të bëhet herrja e pyjeve në këtë rajon, si dhe i falënderoi për këtë projekt, i cili i paraprinë ruajtjes dhe herrjes së pyjeve që është në interesin e komunës së Malishevës, që të kemi pyje të shëndosha dhe u interesuan rreth ruajtjes dhe mbrojtjes së pyjeve.

## Asfaltohet rruga kryesore në qendër të Malishevës

### Malishevë, 24 maj



Në kuadër të mirëmbajtjes së rrugë në Komunën e Malishevës, sot ka filluar asfaltimi i rrugës “Rilindja Kombëtare”, e cila është edhe rruga kryesore dhe më e ngarkuara me automjete. Punimet në rregullimit e kësaj rruge, që nga orët e para të mëngjesit, është duke u përcjellë edhe kryetari i komunës, z.Ragip Begaj dhe drejtori i urbanizimit, z.Skënder Rrahmanaj.

Rruga “Rilindja Kombëtare” është njëra prej rrugëve më të rëndësishme në qytetin e Malishevës, pasi kjo rrugë fillon nga qendra e qytetit dhe lidhë

rrugën magjistrale Prishtinë-Rahovec, ndërsa gjatë kohës, një pjesë e madhe e saj ishte dëmtuar për shkak të ngarkesës.

“Ne po bëjmë përpjekje që infrastruktura të rregullohet dhe të jetë në shërbim të qytetarëve. Dëmtimi i rrugës, përveç pengesës së madhe për vozitësit shkaktonte edhe tollovi në komunikacion dhe detyrë e jona është që të krijojmë kushte për lëvizjen e qytetarëve”, tha kryetari Begaj.

Rregullimi i këtyre rrugëve, është në kuadër të investimeve të komunës, në mirëmbajtjen e rrugëve dhe rregullimi i kësaj rruge, ka një gjatësi prej pesëqind metrave dhe një gjerësi prej shtatë metrave, kurse punimet është duke i kryer kompania “Jehona”, e cila edhe është kontraktuar për mirëmbajtjen e rrugëve.

Punimet e rrugës, pritet të përfundojnë gjatë ditës, ndërsa për mbarëvajtjen e komunikacionit, është duke u kujdesur Policia e Kosovës, sepse kjo rrugë është më e frekuentuara nga automjete.

## Asfaltohen edhe tri rrugë në fshatrat e Malishevës

### Malishevë, 23 maj



Në kuadër të përpjekjeve të komunës, për rregullimin infrastrukturës rrugore dhe krijimit të kushteve më të mira për jetesën dhe lëvizjen e qytetarëve, dje ka përfunduar ndërtimi, përkatësisht asfaltimi i dy rrugëve në fshatin Drenoc dhe i një rruge në fshatin Marali. Asfaltimin e këtyre tri rrugëve, e ka parë nga afër edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj.

Kryetari Begaj, i shoqëruar nga drejtori për urbanizëm, z.Skënder Rrahmanj dhe drejtori i shërbimeve publike, z.Milazim Morina, sot i kanë vizituar këto dy fshatra, duke i parë edhe asfaltimin e rrugëve, por edhe kanë inspektuar punimet edhe në disa projekte tjera, si dhe kanë vizituar ambientet e dy shkollave në Drenoc.

Kryetari Begaj, i ka uruar banorët për rrugët e shtruara. “Unë nuk jap premtime, por dëshiroj që fillimisht të angazhohem në kryerjen e punimeve në projektet e caktuara, e më pas qytetari ti gëzon këto investime të komunës dhe atëherë të vlerësohen angazhimet e qeverisë komunale”. Premtimi im i vetëm është se unë do të angazhohem”, ka thënë Begaj.

Rrugët në fshatin Drenoc, kanë një gjatësi prej më shumë se një kilometër, ndërsa ajo në Marali, ka një gjatësi prej rreth pesëqind metrave, të dyja këto rrugë të lagjeve, që i lidhin këto lagje me rrugët kryesore.



egullimit e kësaj rruge, që nga orët e para të mëngjesit, është duke u përcjellë edhe kryetari i komunës, z.Ragip Begaj dhe drejtori i urbanizimit, z.Skënder Rrahmanaj.

Rruga “Rilindja Kombëtare” është njëra prej rrugëve më të rëndësishme në qytetin e Malishevës, pasi kjo rrugë fillon nga qendra e qytetit dhe lidhë rrugën magjistrale Prishtinë-Rahovec, ndërsa gjatë kohës, një pjesë e madhe e saj ishte dëmtuar për shkak të ngarkesës.

“Ne po bëjmë përpjekje që infrastruktura të rregullohet dhe të jetë në shërbim të qytetarëve. Dëmtimi i rrugës, përveç pengesës së madhe për vozitësit shkaktonte edhe tollovi në komunikacion dhe detyrë e jona është që të krijojmë kushte për lëvizjen e qytetarëve”, tha kryetari Begaj.

Rregullimi i këtyre rrugëve, është në kuadër të investimeve të komunës, në mirëmbajtjen e rrugëve dhe rregullimi i kësaj rruge, ka një gjatësi prej pesëqind metrave dhe një gjerësi prej shtatë metrave, kurse punimet është duke i kryer kompania “Jehona”, e cila edhe është kontraktuar për mirëmbajtjen e rrugëve.

Punimet e rrugës, pritet të përfundojnë gjatë ditës, ndërsa për mbarëvajtjen e komunikacionit, është duke u kujdesur Policia e Kosovës, sepse kjo rrugë është më e frekuentuara nga automjete.

## **Këshilli i Drejtorëve: Shumë projekte në realizimin e sipër**

### **Malishevë, 25 maj**

“Gjatë javës kanë përfunduar disa projekte, ku janë asfaltuar katër rrugë nëpër fshatra dhe rruga kryesore në qytet, përderisa sot pritet të asfaltohet edhe rruga në Berishë, ndërsa projektet tjera që janë në realizim e sipër, janë duke shkuar mirë”, tha drejtori i urbanizimit, Skënder Rrahmanaj. Edhe drejtori për bujqësi, z.Hajrullah Mazreku, tha se projekti i serrave, pritet të përfundoj gjatë kësaj jave, përderisa repelimi i kafshëve në fazën e dytë, në kuadër të luftimit të dhe parandalimit të EHKK, është duke shkuar mirë.

E kur jemi të ethet hemorragjike krime kongo (EHKK), drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, tha se “sa i përket situatës epidemiologjike me EHKK, gjendja është shumë e qetë dhe deri më sot, nuk ka asnjë të infektimit”. Ndërsa drejtori për mbrojtje dhe shpëtim, z.Ahmet Morina, tha se “fushata e spërkatjes së zonave endemike, është duke shkuar shumë mirë dhe nuk ka asnjë problem”.

Drejtoresha për kulturë, znj.Blerta Krasniqi, tha se “janë të angazhuar maksimalisht në përgatitjet për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së



Malishevës dhe gjatë ditës së sotme, pritet të finalizohet edhe agjenda nga ana e Këshillit Organizativ”. “Drejtoria jonë është në përgatitje edhe të shënimit të 1 Qershorit Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve”, tha drejtoresha Krasniqi.

Ndërsa drejtori i arsimit, z.Berim Thaçi, deklaroi se “ka përfunduar testi i arritshmërisë dhe janë në pritje rezultateve, ndërsa si drejtori janë të angazhuar në përfundimin me sukses të vitit shkollor 2014-2015”.

Edhe drejtorja e shërbimeve publike, është e angazhuar në rregullimin e parqeve. “Jemi në përfundim të largimit të të gjitha deponive ilegale të mbeturinave, si dhe jemi në përfundim të rregullimit të parqeve në qytet”, tha drejtori i shërbimeve publike, z.Milazim Morina.

Sa i përket inspektoratit, drejtori z.Sejdi Paçarizi, tha se inspektorati komunal, është i angazhuar në kryerjen e shërbimeve për qytetarët, ku ankesat më të mëdha janë me kanalizimet, ndërsa drejtori Paçarizi, u ankua edhe në gjykatat e vendit, për mos efikasitet në kryerjen e lëndëve që inspektorati dërgon në gjykata.

Drejtori i administratës, z.Sami Kafexholli, tha se drejtorja që ai drejton, “është duke kryer obligimet e përditshme në raport me administratën komunale, si dhe janë të angazhuar maksimalisht në kryerjen e shërbimeve për qytetarët, duke shtuar efikasitetin në punë, në mënyrë që dhënia e dokumenteve të kryhet shpejt dhe pa shkaktuar pritje para sporteleve”.

Ndërsa drejtori për gjeodezi dhe kadastër, z.Fatmir Ademaj, njoftoi për angazhimet e drejtorisë në kryerjen e shërbimeve n raport me qytetarët, si dhe për ligjin për kufijtë administrativ, përkatësisht në përcaktimin e disa vendbanimeve, si fshatra.

Në fund, drejtori për buxhet dhe financa, z.Vesel Krasniqi, i ka njoftuar drejtorit për obligimet që drejtoritë kanë, për planifikimet e tyre në hartimin e qarkores së parë buxhetore, si dhe bëri të ditur për kufijtë e përcaktuar për të hyrat vetanake, ku sipas drejtorit Krasniqi, ministria përkatëse, i ka caktuar kufi të lartë, në raport me kapacitetet e Komunës së Malishevës, për realizimin e të hyrave vetanake, por këtë gjë, drejtori, tha se me shkresë do të ankohen në ministri.



## **Këshilli organizativ, përcaktoi agjendën për shënimin e 16 Qershorit**

### **Malishevë, 25 maj**

Këshilli Organizativ, për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, i udhëhequr nga kryetari i komunës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur takimin e radhës, ku në rend dite kishin përcaktimin e agjendës dhe të propozimeve për çmimet të cilat ndahen me rastin e 16 Qershorit.

Pas diskutimeve mes anëtarëve të Këshillit Organizativ, u përcaktuan edhe për agjendën me rastin e shënimit të 16 Qershorit, e cila do të filloj me shumë aktivitete kulturore dhe sportive, të cilat do të mbahen paraprakisht, pastaj mbledhjen solemne të Kuvendit të Komunës, nderimet dhe homazhet dhe manifestimin qendror, si dhe përfundimin e aktiviteteve në mbrëmjen e 16 Qershorit. Agjenda, do të bëhet publike në ditët në vijim, pasi të përfundoj edhe ana teknike e agjendës.

Po ashtu, Këshilli Organizativ, u përcaktua edhe për të ftuarit për datën e 16 Qershorit, ku pritet të ketë shumë të ftuar, nga jashtë vendit dhe brenda vendit, mysafir të ndryshëm nga të gjitha sferat e jetës, e që lidhen me Malishevën.

Sa i përket çmimeve që sipas Statutit të Komunës, janë tri çmime, për trimëri dhe heroizëm “Imer Krasniqi”, për arsim, “Hamdi Berisha”, dhe çmimi për shëndetësi “Shpëtim Robaj”, do të diskutohen në mbledhjen e ardhshme të Këshillit Organizativ, para se të shkojnë në Kuvendin e Komunës për miratim.

## Largohen mbi 600 tonelata mbeturina

### Malishevë, 26 maj



Krahas investimeve në infrastrukturë, Komuna e Malishevës, një nga prioritet e saja ka edhe pastrimin e ambientit, përkatësisht largimin e mbeturinave nga deponitë ilegale të krijuara që nga paslufta dhe për këtë qëllim, edhe këtë vit, është ndërmarrë një aksion i përbashkët me njësinë e “Eko Regjionit” në Malishevë, ku për një muaj e gjysmë, janë larguar mbi 600 tonelata me mbeturina.

“Synim dhe detyrë e jona primare është pastrimi i ambientit dhe me këtë rast kërkoj nga të gjithë qytetarët, që së bashku ta ruajmë ambientin. Të mos hidhen mbeturina aty ku janë larguar, të mos krijohen deponi të reja të mbeturinave dhe në të ardhmen e afërt ti largojmë edhe deponitë tjera që ende kanë mbetur. Tërë projektin e largimit të mbeturinave e konsideroj si shumë të dobishëm, në radhë të parë për ruajtjen e shëndetit”, tha sot kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj.

Ndërsa, menaxheri i njësisë për menaxhimin e mbeturinave, “Eko regjioni” në Malishevë, z.Nuhi Shala, ka deklaruar se deri në përfundimin e këtij projekti, janë larguar apo në rastet ku ka qenë e pamundur largimi, janë varrosur, mbi 600 tonelata me mbeturina.

“Në 44 vendbanime, kanë qenë të evidentuara si pika të zeza, njëqind deponi ilegale të mbeturinave, me mbi 600 tonelata mbeturina dhe të gjitha ato i kemi larguar dhe uroj që të mos krijohen deponi të tilla të reja” tha Shala.

Sipas Shalës, bashkëpunimi me qytetar, kryesisht ka qenë në nivel dhe kanë marrë falënderime nga ana e qytetarëve, për këtë aksion.

Përndryshe, sipas menaxherit Shala, shumica e fshatrave të Malishevës, tashmë kanë hyrë në sistemin e grumbullimit të mbeturinave, por problem vazhdon të mbetet, hedhja e mbeturinave inerte, pasi qytetarët, i hedhin ato mbeturina, vend e pa vend, duke e degraduar ambientin.



## Berisha bëhet me rrugë të asfaltuara

### **Malishevë, 26 maj**



Fshati Berishë, i cili gjendet në zonën më të thellë të Komunës së Malishevës, në thellësi të bjeshkëve të Berishës, nga sot, i ka të ndërtuara shumicën e rrugëve nëpër lagje. Kjo, pasi Komuna e Malishevës, ka investuar në rregullimin, përkatësisht zgjerimin dhe asfaltimin e tri rrugëve në lagjet e fshatit. Për këtë investim, banorët e fshatit, e kanë falënderuara kryetarin Begaj, për këtë investim.

“Unë me marrjen e detyrës së kryetarit, kam deklaruar se do të mundohem të bëj investime në fshatrat më të largëta dhe aty ku ka munguar në të kaluarën investimet. Ju e gëzofshi këtë rrugë dhe unë besoj se ky investim i yni, është njëri prej investimeve më me rëndësi, pasi jeta e banorëve në zonat e thella është më e vështirë, por nga sot, në tërësi jeni të lidhur me të gjitha rrugët e asfaltuara”, tha kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, pasi vizitës së bërë në Berishë, i shoqëruar nga drejtori i urbanizimit z.Skënder Rrahmanaj.

Banorët e Berishës, e kanë falënderua komunën dhe kryetarin Begaj, për këtë investim domethënës për fshatin e tyre, pasi zgjerimi dhe asfaltimi i rrugëve ju lehtëson në masë të madhe qarkullimin, lidhjen mes lagjeve dhe me rrugën kryesore.

Drejtori urbanizimit, Skënder Rrahmanaj, tha se tri rrugët e lagjeve në Berishë kanë një gjatësi prej 1.3 kilometra dhe të tri rrugët lidhen me rrugën kryesore që e lidh fshatin me rrugët kryesore dhe me qendrën komunale.

## Po vazhdon fushata e dezinfektimit kundër rriqrave

### Malishevë, 28 maj



Fushata e dezinfektimit kundër rriqrave, po vazhdon në territorin e Komunës së Malishevës, dhe deri më tani fushata e dezinfektimit, ka përfunduar në pesë fshatra, Drenoc, Carrallukë, Lladroc, Senik dhe Astrazup, ndërsa sot është duke vazhduar në Dragobil, përderisa situata epidemiologjike, është e qetë dhe nuk ka raste të infektuara me ethe hemorragjike.

Fushata e dezinfektimit kundër rriqrave, bëhet në kuadër të luftimit dhe parandalimit

të etheve hemorragjike krime kongo (EHKK).

Drejtori i drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Ahmet Morina, tha se “fushata e dezinfektimit, po ecën mirë dhe pa probleme, përderisa edhe banorët e këtyre vendbanimeve po shprehen të kënaqur, pasi ndihen më të sigurt, pas dezinfektimit dhe bashkëpunimi me banorët, është shumë i mirë”.

Ndërsa, sa i përket situatës epidemiologjike, gjendja aktualisht, është e qetë, pasi pavarësisht rasteve të thumbimeve, nuk ka asnjë rast të regjistruar me ethe hemorragjike. “Jemi duke punuar vazhdimisht dhe me kujdes të shtuar në përcjelljen e situatës dhe fatmirësisht, këtë vit nuk kemi asnjë rast të regjistruar me ethe hemorragjike, por pavarësisht kësaj, jemi shumë të kujdesshëm në përcjelljen e situatës”, tha drejtori për shëndetësi z.Hajdin Berisha.

Drejtori Morina, ka bërë të ditur, se drejtoria që drejton, në vazhdimësi e ”menaxhon fushatën e dezinfektimit dhe pavarësisht që ministria përkatëse, është duke financuar fushatën e dezinfektimit, për vetëm 1500 hektar, ne nuk do të ndalemi deri në dezinfektimin e tërë territorit, pasi aktualisht kjo është mënyra e vetme e parandalimit të EHKK”.

## Pas njoftimit nga qytetari E.Mazreku, largohet edhe një deponi e mbeturinave

**Malishevë, 29 maj**



Komuna e Malishevës në bashkëpunim me njësinë e “Eko regjionit” në Malishevë, kanë larguar mbi 600 tonelata mbeturina, nga 100 deponi ilegale të evidentuara, të grumbullimi të mbeturinave, mirëpo, kjo nuk do të thotë se janë të evidentuara të gjitha pikat e zeza të mbeturinave dhe pas marrjes së njoftimit nga një qytetar i Malishevës, kompania për menaxhimin e mbeturinave, e ka larguar edhe atë deponi ilegale.

Sipas zyrtarëve komunal, deponia gjendej në një pronë private dhe nuk ka qenë e evidentuar në mesin e pikave të zeza të deponive ilegale të mbeturinave, pasi askush paraprakisht, nuk ka njoftuar për të, mirëpo, me të parë njoftimin nga qytetari Esat Mazreku nga Malishevë, menjëherë është reaguar për largimin e asaj deponie.

Edhe kompania e “Eko regjionit”, ka thënë se nuk kanë pasur në listë dhe në planin e saj, atë deponi, por menjëherë, pasi është kuptuar për ekzistimin e saj, është reaguar për eliminimin e saj.

Me këtë rast, ju bëhet thirrje, të gjithë atyre qytetarëve, që kanë njohuri për ekzistimin e këtyre lloj deponive, ti lajmërojnë në drejtorinë e shërbimeve publike, në mënyrë që të futen në listën për largimin e atyre deponive dhe në të njëjtën kohë, ju bëhet thirrje qytetarëve, që të mos i hedhin mbeturinat përsëri, pasi tashmë shumica e fshatrave, janë nën menaxhim për grumbullimin e mbeturinave.